



- [Të Reja](#) [Policia e Shtetit](#) [Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar](#) [Shërbime](#) [Baza ligjore](#) [Vendndodhjet e policisë](#) [Video](#)
- [Programi i transparencës](#) [Kontakt](#) [Denonco Krimin Kibernetik](#) [Drejtoritë Vendore të Policisë](#) [Policia Kufitare](#) [Policia Rrugore](#)
- [Donacione](#) [Rubrika Policimi në Komunitet](#) [Përmbledhja Javore](#) [Për sinjalizimin](#)

Breaking News:

Tiranë – Viojnë kontrollet në kuadër të operacionit “Sundimi i ligjit”, në pranga 1 shtetas Mat/Zbardhet në kohë rekord vjedhja me thyerje e ndodhur gjatë natës në një objekt kulti (xhami), në qytetin e Burrelit DVP Durrës/U kapën në flagrancë, në 5 lokale në Durrës dhe në Kavajë, duke vënëaste sportive, me celularë, vihen në pranga 7 shtetas DVP Elbasan/Vihen në pranga 2 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 3 të tjerë, për vepra të ndryshme penale DVP Lezhë – Sekuestrohen 40 kilogramë e 200 gramë kanabis, 3 shtetas në pranga



Lajmet Operacionet

13/11/2023

Tiranë – Viojnë Kontrollet Në Kuadër Të Operacionit “Sundimi I Ligjit”, Në Pranga 1 Shtetas

Tiranë/Viojnë kontrollet në kuadër të operacionit policor të koduar “Sundimi i ligjit”, për kapjen e shtetasve të shpallur në kërkim, të shtetasve që qarkullojnë me armë zjarri dhe të atyre që mbajnë në banesë armë, municion ose drogë.

Si rezultat i kontrolleve, është kapur në flagrancë një 40-vjeçar që qarkullonte me armë zjarri pistoletë, në automjet.

Në momentin e ndalimit në rrugë, 40-vjeçari i papajisur me leje drejtimi, iu ka paraqitur punonjësve të Policisë, lejen e drejtimit të një shtetasi tjetër.

Sekuestrohen arma e zjarrit pistoletë me krehër me fishekë dhe automjeti që 40-vjeçari e drejtonte pa leje drejtimi.

Shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja” kanë intensifikuar kontrollet në kuadër të operacionit policor të koduar “Sundimi i ligjit”, për evidentimin dhe goditjen e rasteve të paligjshmërive, kryesisht për kapjen e shtetasve në kërkim dhe të atyre që qarkullojnë me armë zjarri.

Gjatë kontrolleve të kryera në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, në rrugën “Vangjel Noti”, është ndaluar automjeti me drejtues shtetasin A. K.

Pas ndalimit të automjetit, ky shtetas iu ka paraqitur punonjësve të Policisë, një leje drejtimi me gjeneralitete të një shtetasi tjetër. Nga verifikimet e kryera rezultoi se shtetasi A. K. nuk ishte i pajisur me leje drejtimi.

Gjatë kontrollit në automjetit, u gjetën një armë zjarri pistoletë me municion luftarak, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, bashkë me automjetin.

Në përfundim të veprimeve procedurale u arrestua në flagrancë shtetasi A. K., 40 vjeç, banues në Fushë Krujë, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve,armëve shpërthyes dhe i municionit” dhe “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”.

Operacioni “Sundimi i ligjit” vijon.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pra Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Mat/Zbardhet në kohë rekord vjedhja me thyerje e ndodhur gjatë natës në një objekt kulti (xhami), në qytetin e Burrelit